



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 798/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Naser Bytyqi kandidat për kuvendin komunal në Lipjan nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**Refuzohet** si i pabazuar apeli i parashtruar nga Naser Bytyqi kandidat për kuvendin komunal në Lipjan nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpallje së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

#### A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.11.2017 në ora 19:05, ka pranuar një apel nga Naser Bytyqi kandidat për kuvendin komunal në Lipjan nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega Lipjan në të cilin thekson se në qendrën e votimit 1321e/02D në Gllogovc, 1312e/01D në Bujan, 1323/01R në Rufe, 1307e/07 në Gadime, 1304e/02R në Shalë, 1307/06R në Gadime, 1302e/02R dhe 05R në Magure, 1303e/01R në Janjevë, raportet e komisionerëve dhe vëzhguesve nuk përshtaten me raportet e FRK-së dhe FPR-së.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të provave, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **apeli është i pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara për shkak të mungesës së dëshmimeve lidhur me pretendimet e parashtruara në apel.

Parashtrimet në apel nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në vendvotimet e sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për apeluesin .

Paneli vlerësoi se pretendimet në apel nuk janë të bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 10.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete lidhur me pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pa argumentuar me fakte dhe si i tillë është i pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë duke u bazuar ne nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
ZL Anr.798/2017 më datën 12.11.2017.



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.